



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 2009 Prot

Shkodër, më 04.06.2025

URDHËR

Nr. 72, Datë 04.06.2025

**"PËR SHPALLJEN E DITËS SË FILLIMIT TË PROCESIT ZGJEDHOR DHE DATËS
SË ZGJEDHJEVE, PËR AUTORITETET DREJTUESE NË NJËSITË BAZË DHE
NJËSITË KRYESORE QË NUK KANË AUTORITET DREJTUES TË ZGJEDHUR"**

Bazuar në nenin 36, pika 7 dhe nenin 39 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Shkodrës", e ndryshuar, neni 4, pika 12; neni 5, pika 3; Urdhërit të MAS nr. 101, datë 13. 03.2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë";

URDHËROJ:

1. Dita e fillimit të procesit zgjedhor për autoritetet drejtuese të njësive bazë dhe njësive kryesore që nuk kanë autoritet drejtues të zgjedhur është data **4 Qershor 2025**.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese të njësive bazë dhe njësive kryesore në USH, të cilat nuk kanë autoritet drejtues të zgjedhur është data **24 Qershor 2025**.
3. Njësitë bazë dhe njësia kryesore që do t'i nënshtrohen procesit të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese, janë:
 - a. Fakulteti i Drejtësisë (njësi kryesore);
 - b. Departamenti i të Drejtës Publike (njësi bazë);
 - c. Departamenti i Gjermanistikës, (njësi bazë);
 - d. Departamenti i Turizmit, (njësi bazë);



- e. Departamenti i Letërsisë, (njësi bazë);
 - f. Departamenti i Fizikës, (njësi bazë);
 - g. Departamenti i Gjeografisë; (njësi bazë);
 - h. Qendra e Studimeve të Ujrave të Rajonit të Shkodrës (njësi bazë);
4. Ky Urdhër i përcillet për njohje e zbatim të gjitha njësive bazë dhe njësisë kryesore, të renditura në pikën 3, të këtij urdhëri, si dhe Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), KZF-ve përkatëse, Komisionit të Apelimit, Administratorit të USH-së.
5. Ky Urdhër të publikohet në faqen zyrtare të USH-së.
6. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. dr. Faton Gjura

